




Funded by  
the European Union



# URA E KURÇAJT



CH  
WB  
Cultural  
Heritage without Borders  
ALBANIA







# URA E KURÇAJT



*Ky libërth është krijuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.*

*Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e CHWB Albania dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe/ose UNOPS-it.*

CH  
WB  
Cultural  
Heritage without Borders  
ALBANIA

# URAT JANË SHUMË INTERESANTE.

Ato janë ndërtuar nga njerëzit që në lashtësi, për të kaluar ujërat e lumenjve dhe përrenjve.




EUROPA


AZIA

NË KOHËN TONË  
ATO LIDHIN EDHE  
BRIGJET E DY  
KONTINENTEVE, SI URA  
E BOSFORIT NË TURQI.

## URAT I GJEJMË NGADO:



MBI UJË



MBI TOKË

### NË KINEMA



"PO ME URËN  
Ç'PATËN?!"

### NË LETËRSI



### NË SPORT

"LE TË BËJMË  
USHTRIMIN E  
URËS!"




# URAT NA NDIHMOJNË TË SHKOJMË NGA NJË VEND NË TJETRIN

duke kapërcyer një pengesë uji që nuk e  
kalojmë dot më këmbë.


Në fillim urat ishin të thjeshta prej  
druri, më pas u ndërtuan ura të forta prej guri.  
Në kohët moderne filloi ndërtimi i  
urave metalike.



URA DRURI




URA GURI



URA HEKURI



Si në të kaluarën dhe në të tashmen, për të vendosur se çfarë lloj ure do të ndërtohej, tre elementë janë kryesorë:



**FORCAT**  
QË USHTROHEN MBI URË



# KRAHINA E KRUJËS

Ka qenë gjithmonë një kryqëzim i rëndësishëm rrugësh që lidhin të gjitha anët e Shqipërisë, veriun me fushën e Tiranës, si dhe zonat e lindjes me bregdetin.

Për ta bërë këtë udhëtim sa më të shkurtër e të sigurt, duhej të ndërtoheshin shumë ura, pasi kjo krahinë është e pasur me kroje. Rrugës për në det këtyre ujërave u bashkohen edhe përrenj, duke krijuar kështu lumenjtë.




KROI I BALLABANECIT

KROI I SAXHËS

KROI I SUBASHIT

KROI I KRYESHKOZËS






# KARVANET

ishin grupe tregtarësh që udhëtonin mbi kuaj dhe përshkonin distanca të largëta për të bërë tregti.

Një karvan kishte zakonisht dhjetë kuaj. Ai drejtohej nga qiraxhiu. Shpeshherë, karvanet udhëtonin së bashku, duke formuar një varg mjaft të gjatë. Kuajt e karvanit të parë ishin të pajisur me kambana, për të ndihmuar karvanet e tjera pasardhëse të mos humbisnin kur udhëtonin natën apo në shtigjet e maleve buzë honeve.




E ke dëgjuar shprehjen:

**"QENTË LE  
TË LEHIN,  
KARVANI  
SHKON  
PËRPARA".**

# NË KOHË LUFTË

Shpeshherë urat pëcaktonin fatin e një beteje, madje dhe të vetë luftës. Ndaj gjeneralët e ushtarët i kushtonin mjaft rëndësi kontrollit dhe sigurisë që të mbronin dhe të zotëronin urat.



# NË KOHË PAQEJE

## MBI URË KALONTE EDHE KARVANI I DASMORËVE

Pasi merrnin nusen, krushqit u binin  
veglave muzikore dhe këndonin  
e vallëzonin gjithë rrugës gjersa  
mbërrinin në shtëpinë e dhëndrit.

Kur ndodhte që nuset të këmbeshin rrugës me një  
karvan tjetër dasmorësh, ishte zakon që ato të këmbenin  
shamitë me njëra-tjetrën në shenjë paqeje dhe urimi.



**KRUJË**



Ura e Abdyl Agës

Ura e Kurçajt ishte pjesë e një shtegu nga i cili kalonte **SKENDERBEU**.  
Ai e përdorte këtë rrugë për të shkuar në kalanë e Petralbës,  
ku strehohej familja e tij gjatë luftërave me osmanët.

Rruga e vjetër  
mesjetare

Ura e Kurçajt



Qyteti antik i  
Zgërdheshit

**PETRALBË**



PO VIJNË PUSHTUESIT  
OSMANË! FORCA, NDIQ  
LUMIN E ZEZËS PËR TË  
KALUAR NGA KRUJA NË  
PETRALBË.



Fshati Kurçaj



Fshati Mukje



# TË LUMTË, MBËRRITE NË PETRALBË

DUKE KALUAR  
NGA **URA E KURÇAJT!**  
A E VURE RE SI ISHTE?

**KANRET (DRITARET)**

**KYÇI I HARKUT**

**TIRANTAT**


**PARAPETËT**

**HARKU**

Ajo është **NJË URË GURI ME HARK**,  
tipike e urave që ndërtoheshin nga këto anë duke filluar nga shek. i 17-të e në vijim.  
Urat prej guri kanë disa elemente të veçanta që i bëjnë ato të forta.

Gjeji ato në urë:

# POR SI NDËRTOHESHIN KËTO URA?



çfarë të bën më  
shumë përshtypje  
në figurën e  
mësipërme?

**SOT** URAT E VJETRA MBROHEN  
DHE MIRËMBAHEN DHE KA SPECIALISTË QË KUJDESEN PËR TO.



MJESHTRI

PUNON ME  
MATERIALE  
DHE TEKNIKA  
TRADICIONALE

ARKITEKTJA



INXHINIERI DHE  
ARKITEKTJA  
PLANIFIKOJNË DHE  
ZBATOJNË BASHKË TË  
GJITHA RIPARIMET E  
NEVOJSHME.



INXHINIERI

PUNËTORI

KRYEN ME  
KUDJES  
RIPARIMET E  
NEVOJSHME.






# KA RËNË TËRMET!

Jepi një dorë mjeshtrave që po restaurojnë urën.

RIPARO PARAPETËT E VJETRA DUKE RIVENDOSUR GURËT E RRËZUAR. VETËM NËSE ËSHTË E NEVOJSHME SHTO GURË TË RINJ.



KONTROLLO HARKUN. SIGUROHU QË NUK KA ÇARJE.



KONTROLLO KËMBËT E URËS. ATO MUND TË JENË GËRRYER DHE DOBËSUAR NGA UJI.



MBUSH ME LLAÇ DHE ME GURË PJESËN E DËMTUAR SIPAS TEKNIKAVE TË VJETRA.



SHIKO KAMAREN TJETËR PËR TA RIBËRË QEMERIN SIÇ ISHTË.





## SOT URA E KURÇAJT

ËSHTË NJË DESTINACION TURISTIK.

E gjithë zona është për  
t'u vizituar dhe shijuar.





URA E MESIT




URA E ZOGUT

# NË SHQIPËRI

KA RRETH **TETËDHJETË URA** QË RENDITEN  
NË LISTËN E MONUMENTEVE TË KULTURËS.

A e di se ku ndodhen këto ura?  
Kërko për vendndodhjen e secilës urë dhe shkruaje te kutiza poshtë figurës.



URA E DRAGOTIT



URA E GORICËS




ATO JANË NDËRTUAR GJATË  
KOHËRAVE ME MATERIALE  
DHE FORMA NGA MË TË  
NDRYSHMET.



URA E KATIUT OSE E KADIUT



URA E TABAKËVE



# FJALORTH



**ARKITEKT** - profesionisti që krijon formën dhe pamjen e një ndërtese - edhe të urave.

**HARKU I URËS (QEMERI)** - hark prej guri, që kalon nga një këmbë e urës në tjetrën. Ai është element kyç ndërtimor.

**KALLDRËM** - rrugë e shtruar me gurë të vendosur njëri pranë tjetrit.

**KAMARË** - hapësirë e vogël në murin e urës e krijuar për të përballuar vërshimet e ujit.

**KARVAN** - karvanet ishin grupe tregtarësh që përshkonin distanca të largëta për të bërë tregti.

**HON** - gropë e madhe dhe e pakalueshme, greminë, humnerë.



**KRUA** - burim uji, që në vendin ku del rregullohet zakonisht me një gjuhëz druri ose guri.

**KYÇI** - guri qendror i harkut, që e mban atë dhe urën të bashkuar.

**LUMË** - rrjedhë natyrore e madhe uji që del nga një burim, gjarpëron midis malesh e fushash dhe derdhet në det.

**MONUMENT KULTURE** - ndërtime me vlerë kulturore, historike dhe artistike.

**PARAPET** - pjesë e sipërme e urës që ndërtohet në dy anët e saj për të siguruar kalimtarët.

**PËRROSKË** - përrua i vogël, rrëke uji, që zakonisht thahet në verë.

**PËRRUA** - rrjedhë uji më e vogël se lumi, që zbret me rrëmbim nga malet.

**RESTAURIM** - ndërhyrjet me qëllim plotësimin dhe jetëgjatësinë e objekteve dhe monumenteve që janë pjesë e trashëgimisë sonë kulturore materiale.

**SHTEG** - rrugë e ngushtë dhe shpesh e fshehur për të kaluar diku.

**TIRANTA METALIKE** - shufra hekuri që vendosen midis gurëve të harkut ose harqeve të urës.







EMRI .....

ÇFARË TË BËRI  
MË SHUMË  
PËRSHTYPJE NGA  
LY LIBËRTH?  
NA TREGO  
MBRESAT E TUA:

Lined writing area with dashed midlines.





Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë



Teatri Kombëtar i Kukullave, Tiranë



Ministria e Kulturës, Tiranë




Ndërtesa e Institutit të shkencave Politike, Tiranë



Muzeu Arkeologjik, Durrës



Muzeu Etnografik, Durrës



Hamami, Durrës



Torra Veneciane, Durrës



Kisha e Shën Ndojit, Rodon



Kalaja në Ishëm



Muzeu Etnografik, Krujë



Ura e Kurçajt, Krujë



Kisha e Manastirit, Rubik



Rrënojat e Kishës së Shën Mërisë, Mamurras



Ish-Arqipeshkvia, Laç



Kalaja e Lezhës



Muzeu Etnografik, Kavajë




Kalaja e Bashtovës, Rrogozhinë

## NË TË NJËJTIN GJERDAN LIBËRTHASH DO TË GJENI



GJERDANI I LIBËRTHAVE, PJESË E SË CILIT ËSHTË DHE KY BOTIM,  
ËSHTË PJESË E PROJEKTIT  
“**PLATFORMAT E FUQIZIMIT DHE TË MËSIMIT PËRMES TRASHËGIMISË**”  
TË FINANCUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN NË KUADËR TË PROGRAMIT  
EU4CULTURE, TË ZBATUAR NGA UNOPS-I NË KOORDINIM ME MINISTRINË E  
KULTURËS.

Ky projekt, i cili u zbatua nga CHwB Albania, mundësoi realizimin e katër libërthave për fëmijë mbi Muzeun Etnografik të Kavajës, Muzeun Etnografik të Krujës, Urën e Kurçajt (Krujë) dhe Kalanë e Bashtovës (Rrogozhinë). Këto libërtha u bashkëkrijuan me përfaqësues nga institucionet publike vendore e qendrore, profesionistë e qytetarë aktivë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore nga qytetet përkatëse. Qëllimi i këtyre libërthave është forcimi i njohurive të fëmijëve të moshave 6 - 11 vjeç mbi disa prej vlerave më të veçanta të trashëgimisë sonë kulturore, si dhe të shërbyerit si mbështetje për aktivitete praktike pranë siteve të përmendura e jo vetëm, që kanë trashëgiminë kulturore në fokus.



### **URA E KURÇAJT**

**Botues:** Cultural Heritage without Borders Albania (CHwB Albania)

**Koncepti:** Mirian BLLACI, Arnold KAPINOVA, Ledia KOSTANDINI

**Konsulent për materialin historik:** Valter SHTYLLA

**Konsulente për tekstin dhe redaktimin:** Luljeta DANO, Rudina ÇUPI

**Ilustrimet:** Ledia KOSTANDINI, Anastas KOSTANDINI

**Përpunimi grafik, faqosja:** Ledia KOSTANDINI

**Drejtues projekti:** Mirian BLLACI

**Botimi i parë:** 2023

© CHwB Albania

**ISBN: 978-9928-801-01-2**

### **CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Ura e Kurçajt / koncept. Mirian Bllaci,  
Arnold Kapinova, Ledia Kostandini ;  
red. e konsult. Luljeta Dano, Rudina Çupi. - Tiranë :  
Cultural Heritage without Borders Albania, 2023  
48 f. : me il. ; 25x25 cm.  
ISBN 978-9928-801-01-2

1.Botime për fëmijë 2.Ura 3.Antikitete 4.Shqipëri

087.5 :904(496.5)

*Ky libërth është krijuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e CHwB Albania dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe/ose UNOPS-it.*





